



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 750/ 4 Prot.

Tiranë, më 16 /11/2017

V E N D I M

Nr. 158, Datë 16/ 11/2017

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË KRYER NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURISË PALUJTSHME MAT "MBI PROCEDURËN E PRANIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTACIONIT PËR REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PASURISË TË PALUJTSHME DHE EVIDENTIMIN E TRAJTIMIN LIGJOR TË MBIVENDOSJEVE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Administrimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, me mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, Drejtorit Përgjithshëm, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit, në mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

V E N D O S A:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Mbi procedurën e pranimit dhe Administrimin të dokumentacionit për regjistrimin fillestar të Pasurisë të Paluajtshme dhe evidentimin e trajtimin ligjor të mbivendosjeve*" për periudhën 01.01.2014 deri më 30.06.2017.
- II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në 14 raste që i përkasin ZK 2161 Klos, sipas referencave nr. 1062, 1185, 1087, 1164, 0012, 0009, 0116, 0088, 0093, 0075, 0161, 0177, 0044, janë regjistruar pasuri të përfituara nga zbatimi i ligjit nr. 7652, datë 01.12.1992 "Mbi privatizimin e banesave shtetërore". Këto regjistrime janë kryer sipas kontratave të shitblerjes fotokopje, me sipërfaqe të pa evidentuara, me mungesa të planimeve të apartamenteve dhe ndërtesave, pa akte noteriale dhe me dokumente të pa noterizuara fotokopje si formulari nr 1, 2 dhe 3, me mungesa në treguesit tekniko-ekonomikë, mungesa të dokumentit justifikues të shlyerjes së vlerës së

privatizimit dhe me mungesa tërësore të dokumentacionit të privatizimit. Në pjesën me të madhe ishin lëshuar çertifikata pronësie, në kundërshtim me Rregulloren e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nr. 184, datë 08.04.1999, Kreu IV, pika 7, në lidhje me regjistrimin e pasurive përfituar nga Ligji nr. 7652, datë 01.12.1992.

Rekomandimi 1.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat bazuar në shkeljet e konstatuara, për pasuritë në ZK 2161 “Klos”, sipas referencave nr. 1062, 1185, 1087, 1164, 0012, 0009, 0116, 0088, 0093, 0075, 0161, 0177, 0044, dhe sipas referencave në zonat e tjera kadastrale në lidhje me regjistrimin e pasurive përfituar nga Ligji nr. 7652, datë 01.12.1992, të marr masa për të kërkuar nga personat përfitues dokumentacionin original mbi të cilët është kryer regjistrimi i këtyre pasurive, si dhe (kontratave të shitblerjes jo fotokopje), me dokumentacion të noterizuar (planimetrit e dokumentacioni tjetër ndihmës), evidentim të sipërfaqeve, me dokumente justifikues të shlyerjes së detyrimeve të noterizuara, në zbatim të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, Kap. VI-të, pika 2 “Pranimi i dokumenteve për regjistrim”.

Brenda muajit Dhjetor 2017

2. Gjetje nga auditimi: Në 14 raste që i përkasin ZK 2161 Klos, është pranuar dokumentacioni dhe janë regjistruar objekte me leje legalizimi sipas referencave nr. 1166, 1225, 1070, 1076, 0329, 1170, 1184, 1095, 1081, 1099, 0896, 0994, 0119, 1077, në pasuri shtetërore evidentuar në KPP me një sipërfaqe ndërtimore **1169 m², duke shkaktuar një dëm ekonomik** në vlerën prej **46,837,154 lekë** (prishje e objekteve shtetërore dhe legalizim mbi to të objekteve private pa u zhdëmtuar vlera e tyre, llogaritur me çmimin e Entit të Banesave ...etj.) **duke vepruar në kundërshtim me procedurat e përcaktuara me** Udhëzimin e Përbashkët të ZRQPP dhe ALUIZNI-t nr. 4695 dhe 4688, datë 31.05.2016 pika 6, 8, 9, 10, dhe VKM nr. 756, datë 26.10.2016 pika 9, në kundërshtim me pikën 8, Seksioni II, të Udhëzimit Metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelave të pasurive të paluajtshme” dhe Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, Kreu II, pika 10.6, me nenin 42, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 dhe me pikën 2 e 3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Rekomandimi 2.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marr masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në ZK 2161 “Klos”, sipas referencave nr. 1166, 1225, 1070, 1076, 0329, 1170, 1184, 1095, 1081, 1099, 0896, 0994, 0119, 1077 deri në arkëtimin detyrim të **46,837,154 lekë përfituar padrejtësisht nga 14 subjektet** sipas referencave evidentuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit sipas çmimit aktual të EKB-së.

Brenda muajit Shkurt 2018

3. Gjetje nga auditimi :

a. Në 3 raste që i përkasin ZK 2161 Klos, sipas referencave nr. 1140, 1152, 1153 regjistruar trull 450 m² dhe ndërtesë. 257 m². në kundërshtim me procedurat e përcaktuara nga VKM 608, datë 05.09.2012, pikat, 5, 6, 8, 9, dhe në papajtueshmëri me pikën “iii” shkronjës “b” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me **mungesa të**

dokumentacionit zyrtar nga Pushteti Vendor që provojnë se ndërtimet janë bërë para vitit 1991. Meqenëse subjekti S.T ka përfituar padrejtësisht truallin në bazë të VKM nr. 812, datë 16.11.2016 duhet të shlyejë detyrimin për blerjen e truallit në vlerën 600,000 lekë.

*b. Në 1 rast që i përket ZK 2161 Klos, sipas referencës nr. 1124, regjistruar truall 200 m² dhe ndërtesë. 97 m² në kundërshtim me procedurat e përcaktuara nga VKM 608, datë 05.09.2012, pikat, 5, 6, 8, 9, dhe në papajtueshmëri me pikën “iii” shkronjës “b” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me **mungesa të dokumentacionit zyrtar nga Pushteti Vendor që provojnë se ndërtimet janë bërë para vitit 1991. Sipas dokumentacionit arkivor 321/, datë 27.11.2015 në praktikën e regjistrimit evidentohet** V. K. Ekz. KP Mat nr. 93, datë 27.07.1988 “Për lirimin e sheshit të ndërtimit të hekurudhës” që sipas të cilit pronari i shtëpisë rezulton të jetë kompensuar financiarisht. **Meqenëse subjekti A.M ka përfituar padrejtësisht truallin në bazë të VKM nr. 812, datë 16.11.2016 duhet të shlyejë detyrimin për blerjen e truallit në vlerë 300,000 lekë.***

Rekomandimi 3.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marr masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në ZK 2161 “Klos”, sipas referencave nr. 1140, 1152, 1153 dhe 1124, deri në plotësimin e dokumentacionit e duhur ligjor dhe shlyerjen e detyrimeve në vlerën 900,000 lekë** që vijnë si rezultat i zbatimit VKM nr. 812, datë 16.11.2016.

Brenda muajit Dhjetor 2017

4. Gjetje nga auditimi: *Në 1 rast që i përket ZK 2466 Lis, sipas referencës 0340, është regjistruar një pasuri me pjesëtim nr. 233/6, sipas LN 4375 m² tokë “Arë”, ndërsa sipas AMTP rezultojnë, ndërsa sipas AMTP rezulton një sipërfaqe 4300 m² duke regjistruar me tepër 75 m² pa u veçuar si pasuri shtet, në kundërshtim me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, i ndryshuar, me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” me udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.06.2013 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP)” dhe me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, pika 2.*

Rekomandimi 4.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marr masa që në të ardhmen të bëhen bilancet e tokës “Arë”, “Pemishte”, “Vreshta”, Ullishte”, krahasimi LN-Printimi III – AMTP, për të gjithë rastet kur kryhen veprime mbi këto pasuri të cilat janë në pronësi të përfituesit të parë dhe jepen certifikata pronësie, duke mos tejkualuar në asnjë rast sipërfaqen e përgjithshme sipas AMTP-ve për secilin subjekt, si dhe duke kaluar në “Shtet” diferencat në “plus” kur këto pasuri janë regjistruar më shumë sipas LN-Printimi III.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: *Në 1 rast që i përket ZK nr. 2466 “Lis”, për sipërfaqen 15000 m² sipas referencave nr. 0000146 dhe 0000148, datë 28.12.2002, për pasuritë nr.1/1 dhe nr. 82/1/8, është bërë ndryshimi i llojit të pasurive (zërave kadastralë), nga “Pyll” dhe sipërfaqe “Shkëmbore” në tokë “Arë”, sipas AMTP pa nr. , ky ndryshim është bërë pa pasur plan rievimi të nënshkruar dhe konfirmuar nga Kryetari i Komunës dhe Kryetari i Fshatit, në kundërshtim me*

nenin 11/1, pikat 4, 4/1, 4/2, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionet e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar dhe në kundërshtim me ligjin nr. 7623, datë 13.10.1992 “Për pyjet dhe Policinë e Shërbimit Pyjor” (ligji i kohës), nenet 2 dhe 7, ku miratimi i heqjes nga fondi pyjor duhej të bëhej nga Drejtori i Përgjithshëm i Pyjeve dhe Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

Rekomandimi 5.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marr masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 1/1 dhe nr. 82/1/8, tokë “Arë”, gjithsej 15000 m², sipas referencave nr. 0000146 dhe 0000148, datë 28.12.2002, në ZK 2466 “Lis”, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko- ligjor (shkresë nga DMMT në Qark, ose miratim nga organet kompetente sipas ligjit). Në të ardhmen të mos kryhen regjistrime të pasurive duke ndryshuar llojin nga “Pyll”, sipërfaqe “Shkëmbore”, në tokë “Arë”, “Pemëtores”, “Ullishte”, “Vreshta”, në mungesë të miratimit nga Këshilli i Ministrave ose ministri përkatës që mbulon mjedisin dhe pyjet, në varësi nga sipërfaqja së cilës i ndryshon zëri kadastral.

Brenda muajit Dhjetor 2017 dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në 27 Zona Kadastrale në zonat urbane janë kryer regjistrime të pasurive truall dhe ndërtesë sipas listave emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive dhe në të gjitha rastet në kolonën e ish-pronarit nuk rezulton të jenë nënshkrimet përkatëse, ndërsa në listat në 19 zona kadastrale rezulton të mos evidentohen në kolonat sipërfaqe e ndërtesës sipërfaqja përkatëse per ZK 3349 Shugjun, ZK 3415 Shqefen, ZK 3680 Unjate, ZK 2887 Patin, ZK 1137 Bejne, ZK 1138 Bel, ZK 1164 Bershi, ZK 1319 Burgajet, ZK 1331 Bushkash, ZK 1391 Cërujë, ZK 1449 Dars, ZK 1468 Derjan, ZK 1644 Fshat, ZK 1651 Fullqet, ZK 2312 Kujtim, ZK 2334 Kurdari, ZK 2545 Macukull, ZK 2990 Peshe, ZK 3044 Prell.

Në 30 raste në ZK nr. 2887 “Patin”, ZK nr. 3415 “Shqefen”, ZK nr. 3680 “Unjate”, regjistruar sipërfaqe ndërtesë për sipërfaqen 2200 m², dhe janë lëshuar dhe certifikata pronësie.

-Në 12 zona kadastrale listat emërore të ish pronareve të ish pronareve të trojeve në zonat urbane rurale nuk ishin nënshkruar nga Kryeplaku .

-Në 6 zona kadastrale listat emërore të ish pronarëve të trojeve në zonat urbane rurale nuk ishin nënshkruar nga Kryetari i Komunës.

Për sa konstatuar si me sipër veprimet e kryera vijnë në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të ZQRPP, nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, Kreu IV, pika 13 dhe me urdhrin e Kryeregjistruesit nr. 3191, datë 11.05.2012 “Unifikimi i procedurave të regjistrimit të pasurive “Truall+Ndërtesë”, në zonat urbane të fshatit, bazuar në aktet e lëshuara nga organet e pushtetit vendor bazuar në VKM 432, datë 14.08.1995 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ne zonën urbane të fshatit”, të shfuqizuar” dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006.

Rekomandimi 6.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marr masa për kryerjen e regjistrimeve të pasurive me 0001 në zbatim të VKM nr. 159, datë 21.03.2006, me hyrjen në fuqi të cilit është ç’fuqizuar VKM nr. në VKM 432, datë 14.08.1995 duke regjistruar pasuritë sipas rasteve të përcaktuara në Urdhrin e K/Regjistruesit nr. 411, datë 14.05.2012 dërguar me shkresën nr. 3192/1, datë 14.05.2012. duke eliminuar mangësitë e evidentuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi si për truallin dhe për ndërtesën.

Brenda muajit Dhjetor 2017 dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në 4 Zona Kadastrale: 2164 Klos Katund, 3403 Shoshaj, 2362 Fshati Laç, 3687 Urxallë, regjistruar pasuri “Truall” dhe “Ndërtesë”, në zonat urbane të fshatrave bazuar në “Listat emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive”, pa u plotësuar kolona për sipërfaqet “Ndërtesë” dhe pa u firmosur nga kryepleqtë dhe subjektet përfitues të trojeve dhe ndërtesave.

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit në volumet e 4 zonave kadastrave, konstatohet se sipërfaqja prej 40601 m² ishte regjistruar në KPP kushtet e mungesës sipërfaqes së ndërtesës në listën emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive, dhe nuk ishin lëshuar certifikata, në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të ZQRPP, nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, Kreu IV, pika 13 dhe me urdhrin e Kryeregjistruesit nr. 3191, datë 11.05.2012 “Unifikimi i procedurave të regjistrimit të pasurive “truall+ndërtesë”, në zonat urbane të fshatit, bazuar në aktet e lëshuara nga organet e pushtetit vendor bazuar në VKM 432, datë 14.08.1995 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ne zonën urbane të fshatit”, të shfuqizuar”.

Rekomandimi 7.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marr masa për kryerjen e regjistrimeve të pasurive me 0001 në zbatim të VKM nr. 159, datë 21.03.2006, me hyrjen në fuqi të cilit është ç’fuqizuar VKM nr. në VKM 432, datë 14.08.1995 duke regjistruar pasuritë sipas rasteve të përcaktuara në Urdhrin e K/Regjistruesit nr. 411, datë 14.05.2012 dërguar me shkresën nr. 3192/1, datë 14.05.2012, duke eliminuar mangësitë e evidentuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi për truallin dhe për ndërtesën.

Brenda muajit Dhjetor 2017 dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në 12 raste, për sipërfaqen 2753.5 m² në ZK 1326 “Burrel-Qytet”, sipas referencave nr. 05560, 06434, 05816, 6078, 5558, 04285, 05626, 6400, 05987, 5601, 4289, 4292, ka kryer regjistrime të pasurive (kalim nga hipotekës në sistem), në 12 raste lloji i pasurive “Njësi”, përfituar nga privatizimi, sipas ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991, në mungesë të dokumentacionit nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit (AKP), të cilat duhej t’i ishin bashkëngjitur praktikave, si kontrate e shit-blerjes mes AKP dhe blerësit për objektin e privatizuar, kontrate për marrëdhëniet me truallin, akti i dorëzimit i nënshkruar nga AKP dhe blerësi, ose kontrata qiraje me afat deri 5 vjeçar, në kundërshtim me ligjin nr. 7512, date 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës se lire, te veprimtarive private te pavarura dhe privatizimit” dhe me Rregulloren e Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, Kreu IV, pika 7.2.

Nga llogaritja e vlerave të objekteve të privatizuar, si dhe të qirave të pa llogaritura *vetëm për periudhën 6 vjeçare 01.07.2011 deri më 01.07.2017*, bazuar në VKM nr. 529, datë 08.06.2011 dhe VKM Nr. 54, datë 5.2.2014 ‘‘Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore’’, **rezulton një dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën 8,436,899 lekë .**

Rekomandimi 8.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marr masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë 7/146/Nd-N3, 7/21/ND, 7/115/ND-N7, 7/202/ND, 7/52/ND, 7/52/ND-N5, 3/145/ND-N4, 7/62/ND-N1, 7/180/ND, 3/44/ND, 4/206-N1, 4/206-N2, në ZK 1326 “Burrel-Qytet”, sipas**

referencave nr. 05560, 06434, 05816, 6078, 5558, 04285, 05626, 6400, 05987, 5601, 4289, 4292, deri në arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga mosplotësimi i dokumentacionit tekniko ligjor për vlerën prej 8,436,899 lekë.

Brenda muajit Dhjetor 2017 dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste që i përkasin ZK 1326 Burrel Qytet, sipas referencave 10666, 10441, 10709, regjistruar sipërfaqja **ndërtimore 277.3 m²** për pasuritë 4/450, 4/492, 4/503 me leje legalizimi në pasurinë pasuritë me status juridik shtet dhe pronar i pa vërtetuar përcaktuar nga ZVRPP, që rezultojnë që ndërtimet e evidentuara nuk janë kryer nga aplikuesit dhe si të tilla lejet e legalizimit nuk duhej të ishin lëshuar nga ALUZIONI Diber dhe nuk duhej ishin regjistruar nga ZVRPP Mat. Sipërfaqet ndërtimore 277.3 m², sipas referencave 10666, 10441, 10709, pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar” të vlerësuara me koston mesatare të ndërtimit të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi, për qytetin e Burrelit sipas EKB, sipas UKM nr. 4, datë 30.09.2015, rezultojnë me një vlerë prej **11,110,301 lekë, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**. Veprimet dhe mosveprimet e kryera për legalizimin e objekteve sipas pasurive të evidentuara më sipër vijnë në kundërshtim me pikat 6, 8 dhe 12, të udhëzimit të përbashkët të Zyrës QRPP dhe ALUZIONI, nr. 4695 dhe 4688, datë 31.05.2016 “Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar” dhe me pikën 9, të VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 280, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtime pa leje” dhe me pikën 9, të VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 280, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtime pa leje”.

Rekomandimi 9.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë 4/450, 4/492, 4/503, në ZK 1326 “Burrel-Qytet”, sipas referencave nr. 10666, 10441, 10709, deri në arkëtimin e detyrimeve nga subjektet përfituese të vlerës prej **11,110,301 lekë**.

Brenda muajit Dhjetor 2017 dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në 6 raste që i përkasin ZK 1326 Burrel Qytet, janë kryer regjistrime sipas referencave 10803, 10804, 10500, 10553, 10576, 10657, **për sipërfaqen 1145 m², në**, legalizime objektivësh në mungesë të marrëdhënieve të pronësisë me parcelën ndërtimore (truallin), pa hyrë në fuqi vendimi i Këshillit të Ministrave që miraton kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore dhe pa u kryer pagesat për parcelat ndërtimore prej pronarëve të objekteve informale. Nuk ishte kërkuar nga ALUZIONI Qarku Diber në momentin e aplikimit online me sist. IPS dhe nuk ishte vendosur nga ZVRPP Mat, hipoteka ligjore në seksionin përkatës (seksioni E) të KPP-ve, në kundërshtim me Kreun III, pikat 13, 14, 15, 16, të VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUZIONI-t dhe ZQRPP-së dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara” dhe Kreun III, pikat 15, 16, të Udhëzimit të Përbashkët të

ZQRPP dhe DP ALUIZNI-t nr. 4688 dhe nr. 4695, date 31.05.2016, “Për Procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimin e certifikatave të pasurisë së paluajtshme të legalizuar”. **Rekomandimi 10.1:** Regjistruesi i ZVRPP Mat të marr masa dhe të vendosë hipotekë ligjore në seksionin përkatës (seksioni E) të KPP-ve, sipas referencave 10803, 10804, 10500, 10553, 10576, 10657, legalizime të kryera për regjistrim të objektit në mungesë të marrëdhënieve të pronësisë me parcelën ndërtimore (truallin), pa hyrë në fuqi vendimi i Këshillit të Ministrave që miraton kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore dhe pa u kryer pagesat për parcelat ndërtimore prej pronarëve të objekteve informale.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në 4 raste, sipas referencave 06199, 7424, 7348, 6970, janë regjistruar pasuri me leje ndërtimi për sipërfaqen **326.25 m²** në zonën kadastrale nr. **1326 “Burrel Qytet” në mungesë të marrëdhënieve të pronësisë me truallin** në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Rregulloren e Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, Kreu IV, pika 12, për lejet në vitet 1998 e në vazhdim, ku vihet detyrim për lidhjen e kontratës së shitjes së truallit midis Këshillit të Rrethit dhe blerësve. Nga llogaritja e vlerës së truallit për sipërfaqen prej 326.25 m², për të cilat mungojnë marrëdhëniet e pronësisë, bazuar në VKM nr. 514, datë 30.07.2014, **rezulton një vlerë prej 426,082 lekë e papaguar, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

Rekomandim 11.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marr masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë 6/178, 6/262/ND2, 4/225/ND1, 6/283/ND, në ZK 1326 “Burrel-Qytet”, sipas referencave nr. 06199, 7424, 7348, 6970, deri në arkëtimin e detyrimit prej 426,082 lekë konstatuar si rezultat i mos përcaktimit të marrëdhënieve të pronësisë së truallit, dhe llogaritjen e qirasë. *Brenda muajit Dhjetor 2017 dhe në vijimësi*

12. Gjetje nga Auditimi: Në 1 rast që i përket ZK 3675, sipas referencës 522, regjistruar me leje ndërtimi pasuria nr. 1/89-Nd, Dyqan-Garazh me sipërfaqe 200 m², në mungesë të dokumentacionit të marrëdhënieve të pronësisë si dhe në mungesë të dokumentacionit tjetër, në kundërshtim me ligjin e Planifikimit dhe zhvillimit të Territorit nr. 10119, datë 23.04.2009, të ndryshuar, ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Rregulloren e Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, Kreu IV, pika 12, për lejet në vitet 1998 e në vazhdim. Nga llogaritja e vlerës së truallit për sipërfaqen prej 200 m², për të cilat mungojnë marrëdhëniet e pronësisë, bazuar në VKM nr. 514, datë 30.07.2014, **rezulton një vlerë prej 82,600 lekë e papaguar, dhe nga llogaritja e qirasë për 3 vjet llogaritet një detyrim i papaguar në vlerën 300,000 lekë që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit .**

Rekomandimi 12.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marr masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 1/89-Nd, në ZK 3675, me referencës nr. 0522, deri në arkëtimin e detyrimit të përcaktuar në këtë Raport

Përfundimtar Auditimi në vlerën prej 300,000 lekë dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor(Lidhjen e kontratës për marrëdhëniet me truallin me qira apo shitje).

Brenda muajit Dhjetor 2017 dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast që i përket zonës kadastrale nr. 1326 “Burrel Qytet”, sipas referencës nr. 11143, regjistruar vendim gjykate me të paditur ZVRPP Mat, Ministria e Drejtësisë dhe Avokatura e Shtetit, të cilët sipas dokumentacionit në dosje nuk rezultojnë të kenë marrë pjesë në gjykim në shqyrtimin e çështjes gjyqësore dhe vendimmarrjen përkatëse, ndërsa në vendim nuk ka asnjë shënim nëse këto palë në mungesë të jenë thirrur si palë në gjykim.

Bazuar si me sipër ZVRPP Mat duhej të pezullonte kërkesën për regjistrim dhe regjistruesi duhej të plotësonte urdhër për regjistrimin e kufizimit në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme, sipas nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, duke njoftuar subjektet përkatëse, deri në një ngjarje të caktuar(paraqitja e dokumentit administrativ i fletë thirrjes për gjykim të palëve të paditura:ZVRPP Mat, Ministria e Drejtësisë dhe Avokatura e Shtetit).

Mosveprimet e trajtuara më sipër bien në kundërshtim me pikën 3, geramat “a” dhe “ç” dhe me pikën 7, të udhëzimit të KM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruesit”.

Rekomandimi 13.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marrë masa për regjistrimin e kufizimit në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së paluajtshme, sipas nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, për rastet e paraqitjes për regjistrim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në kushtet e mungesës së dokumentit administrativ i fletë thirrjes për gjykim të palëve të paditura: ZVRPP Mat, Ministria e Drejtësisë dhe Avokatura e Shtetit. Pas paraqitjes së këtyre dokumenteve ZVRPP mund të vazhdojë me trajtimin e kërkesës për regjistrim.

Në vijimësi

14. Gjetje nga Auditimi: Nga verifikimi i ankesës bërë nga H.R dërguar me shkresën nr. 136/1, datë 24.02.2017 për trajtim rezultoi se ZVRPP Mat, sipas referencës nr. 07289, datë 18.05.2009, ka kryer regjistrim objekti me origjinë “Studio piktorësh”, në mungesë të dokumentit të marrëdhënive me truallin, në zonën kadastrale nr. 1326 “Burrel Qytet”, me pretendimin se nga ZVRPP Mat nuk është vepruar për regjistrimin e pronës së tij “Studio piktorësh”. Sipas referencës nr. 07289, datë 18.05.2009, është kryer regjistrimi në vol. 19, faqe 212, i pasurisë 3/80/ND-S6, për llojin e pasurisë “Studio”, sipërfaqe 442 m², pa truall dhe në seksionin “D” të KPP, është vënë shënimi:, që kjo studio ndodhet mbi trojet 3/270; 3/271; 3/272.

Sipas dokumentacionit në dosje rezultojnë se objektet “Studio piktorësh”, janë falur sipas vendimit të Kryesisë së Këshillit të Rrethit Mat nr. 107, datë 29.12.1993, në mbështetje të Dekretit të Presidentit të RSH nr. 378, datë 27.11.1992 dhe ligjit nr. 440, datë 26.01.1993, “Për faljen e studiove të piktorëve dhe skulptorëve”. Në dokumentacionin e ndodhur në dosje nuk rezultojnë të jenë përcaktuar marrëdhëniet e pronësisë së truallit, në kundërshtim me kreun e IV-të, pika 11. të rregullores nr. 184. Datë 08.04.1999.

Në zbatim të rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 kreu i IV-të pika 11 nga ZVRPP duhet të ishte lidhur kontrata e marrëdhënive me truallin(me dhurim apo me shitje) nga organi i qeverisjes vendore me subjektin përfitues të objektit sikurse është bërë dhe falja e studios me dekret dhe me

vendim të këshillit Qarkut sipas plan vendosjes së objektit të përfituar, meqenëse dhe trualli gjendet brenda juridiksionit të Bashkisë.

Rekomandimi: Regjistruesi i ZVRPP Mat bazuar në shkeljen e konstatuara në lidhje me regjistrimin e objektit studio piktori, pa pasur marrëdhënie me truallin në zbatim të rregullores nr.184, datë 08.04.1999, kreu IV-të pika 11, të marrë masa në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, duke regjistruar truallin e objektit “Studio Piktori” subjektit përfitues së bashku me truallin sipas plan vendosjes në zbatim të rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, duke marrë në konsideratë Dekretin e Presidentit nr. 378 dhe vendimin e Këshillit të Qarkut Mat për faljen e studion së piktorëve.

Brenda muajit Dhjetor 2017

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kapitulli IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike të nxirren aktet administrative duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbartimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën totale **68,010,436 lekë e analizuar si me poshtë:**

Gjetje 1: Në 14 raste që i përkasin ZK 2161 Klos, është pranuar dokumentacioni dhe regjistruar objekte me leje legalizimi sipas referencave nr. 1166, 1225, 1070, 1076, 0329, 1170, 1184, 1095, 1081, 1099, 0896, 0994, 0119, 1077, në pasuri shtetërore evidentuar në KPP me një sipërfaqe ndërtimore **1169 m²**, shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën prej **46,837,154 duke vepruar në kundërshtim me procedurat e përcaktuara me** Udhëzimin e Përbashkët të ZRQPP dhe ALUIZNI-t nr. 4695 dhe 4688, datë 31.05.2016 pika 6, 8, 9, 10, dhe VKM nr. 756, datë 26.10.2016 pika 9, në kundërshtim me pikën 8, Seksioni II, të Udhëzimit Metodik nr. 76, datë

13.09.1999 “Për plotësimin e kartelave të pasurive të paluajtshme” dhe Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, Kreu II, pika 10.6, me nenin 42, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 dhe me pikën 2 e 3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” .

Rekomandimi 1.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në ZK 2161 “Klos”, sipas referencave nr. 1166, 1225, 1070, 1076, 0329, 1170, 1184, 1095, 1081, 1099, 0896, 0994, 0119, 1077 **deri në arkëtimin detyrim të 46,837,154 lekë përfituar padrejtësisht nga 14 subjektet** sipas referencave evidentuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit sipas çmimit aktual të EKB-së.

Brenda muajit Dhjetor 2017 dhe në vijimësi

Gjetje 2:

a. Në 3 raste që i përkasin ZK 2161 Klos, sipas referencave nr. 1140, 1152, 1153 regjistruar truall 450 m² dhe ndërtesë. 257 m². në kundërshtim me procedurat e përcaktuara nga VKM 608, datë 05.09.2012, pikat, 5, 6, 8, 9, dhe në papajtueshmëri me pikën “iii” shkronjës “b” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me *mungesa të dokumentacionit zyrtar nga Pushteti Vendor që provojnë se ndërtimet janë bërë para vitit 1991. Meqenëse subjekti S.T ka përfitur padrejtësisht truallin në bazë të VKM nr. 812, datë 16.11.2016 duhet të shlyejë detyrimin për blerjen e truallit në vlerën 600,000 lekë* .

b.: Në 1 rast që i përkasin ZK 2161 Klos, sipas referencës nr. 1124, regjistruar truall 200 m² dhe ndërtesë. 97 m² në kundërshtim me procedurat e përcaktuara nga VKM 608, datë 05.09.2012, pikat, 5, 6, 8, 9, dhe në papajtueshmëri me pikën “iii” shkronjës “b” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me *mungesa të dokumentacionit zyrtar nga Pushteti Vendor që provojnë se ndërtimet janë bërë para vitit 1991. Sipas dokumentacionit arkivor 321/, datë 27.11.2015 në praktikën e regjistrimit evidentohet V. K. Ekz. KP Mat nr. 93, datë 27.07.1988 “Për lirimin e sheshit të ndërtimit të hekurudhës” që sipas të cilit pronari i shtëpisë rezulton të jetë kompensuar financiarisht. Meqenëse subjekti A.M ka përfitur padrejtësisht truallin në bazë të VKM nr. 812, datë 16.11.2016 duhet të shlyejë detyrimin për blerjen e truallit në vlerë 300,000 lekë* .

Rekomandimi 2.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, **bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në ZK 2161 “Klos”, sipas referencave nr. 1140, 1152, 1153 dhe 1124, deri në plotësimin e dokumentacionit e duhur ligjor dhe shlyerjen e detyrimeve në vlerën 900,000 lekë** që vijnë si rezultat i zbatimit **VKM nr. 812, datë 16.11.2016**.

Brenda muajit Dhjetor 2017 dhe në vijimësi

Gjetje 3: Në 12 raste që i përkasin ZK 1326 “Burrel-Qytet”, për sipërfaqen 2753.5 m² , sipas referencave nr. 05560, 06434, 05816, 6078, 5558, 04285, 05626, 6400, 05987, 5601, 4289, 4292, ka kryer regjistrime të pasurive (kalim nga hipotekës në sistem), në 12 raste, lloji i pasurive “Njësi”, përfitur nga privatizimi, sipas ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991, në mungesë të dokumentacionit nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit (AKP), të cilat duhej t'i ishin bashkëngjitur praktikave, si kontrate e shit-blerjes mes AKP dhe blerësit për objektin e privatizuar, kontrate për marrëdhëniet me truallin, akti i dorëzimit i nënshkruar nga AKP dhe blerësi, ose kontrata qiraje me afat deri 5 vjeçar, në kundërshtim me ligjin nr. 7512, date 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lire, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” dhe me Rregulloren e Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, Kreu IV, pika 7.2. Nga llogaritja e vlerave të objekteve të privatizuar si dhe të qirave të pa llogaritura *vetëm për periudhën 6 vjeçare 01.07.2011 deri më 01.07.2017*, bazuar në VKM nr. 529, datë 08.06.2011 dhe VKM Nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, **rezulton një dëm ekonomik në buxhetin e shtetit në vlerën 8,436,899 lekë** .

Rekomandimi 3.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë 7/146/Nd-N3, 7/21/ND, 7/115/ND-N7, 7/202/ND, 7/52/ND, 7/52/ND-N5, 3/145/ND-N4, 7/62/ND-N1, 7/180/ND, 3/44/ND, 4/206-N1, 4/206-N2, në ZK 1326 “Burrel-Qytet”, sipas referencave nr. 05560, 06434, 05816, 6078, 5558, 04285, 05626, 6400, 05987, 5601, 4289, 4292, deri në arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga mosplotësimi i dokumentacionit tekniko ligjor për vlerën prej **8,436,899 lekë**.

Brenda muajit Dhjetor 2017 dhe në vijimësi

Gjetje 4. Në 3 raste që i përkasin ZK 1326 Burrel Qytet, sipas referencave 10666, 10441, 10709, regjistruar sipërfaqja **ndërtimore 277.3 m²** për pasuritë 4/450, 4/492, 4/503 me leje legalizimi në pasurinë pasuritë me status juridik shtet dhe pronar i pa vërtetuar përcaktuar nga ZVRPP, që rezultojnë që ndërtimet e evidentuara nuk janë kryer nga aplikuesit dhe si të tilla lejet e legalizimit nuk duhej të ishin lëshuar nga ALUZIONI Dibër dhe nuk duhej ishin regjistruar nga ZVRPP Mat. Sipërfaqet ndërtimore 277.3 m², sipas referencave 10666, 10441, 10709, pronë “Shtet” dhe “Pronar i pavërtetuar” të vlerësuara me koston mesatare të ndërtimit të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi, për qytetin e Burrelit sipas EKB, sipas UKM nr. 4, datë 30.09.2015, rezultojnë me një vlerë prej **11,110,301 lekë, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**. Veprimet dhe mosveprimet e kryera për legalizimin e objekteve sipas pasurive të evidentuara më sipër vijnë në kundërshtim me pikat 6, 8 dhe 12, të udhëzimit të përbashkët të Zyrës QRPD dhe ALUZIONI, nr. 4695 dhe 4688, datë 31.05.2016 “Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar” dhe me pikën 9, të VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 280, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtime pa leje” dhe me pikën 9, të VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 280, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtime pa leje”.

Rekomandimi 4.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë 4/450, 4/492, 4/503, në ZK 1326 “Burrel-Qytet”, sipas referencave nr. 10666, 10441, 10709, deri në arkëtimin e detyrimeve nga subjektet përfituese të vlerës prej **11,110,301 lekë**.

Brenda muajit Dhjetor 2017 dhe në vijimësi

Gjetje 5: Në 4 raste, sipas referencave 06199, 7424, 7348, 6970, janë regjistruar pasuri me leje ndërtimi për sipërfaqen **326.25 m²** në zonën kadastrale nr. 1326 “Burrel Qytet” në mungesë të marrëdhënieve të pronësisë me truallin në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Rregulloren e Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, Kreu IV, pika 12, për lejet në vitet 1998 e në vazhdim, ku vihet detyrim për lidhjen e kontratës së shitjes së truallit midis Këshillit të Rrethit dhe blerësve.

Nga llogaritja e vlerës së truallit për sipërfaqen prej 326.25 m², për të cilat mungojnë marrëdhëniet e pronësisë, bazuar në VKM nr. 514, datë 30.07.2014, **rezulton një vlerë prej 426,082 lekë e papaguar, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**.

Rekomandim 5.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë 6/178, 6/262/ND2, 4/225/ND1, 6/283/ND, në ZK 1326 “Burrel-Qytet”, sipas referencave nr. 06199, 7424, 7348, 6970, deri në arkëtimin e detyrimit prej 426,082 lekë, konstatuar si rezultat mos përcaktimit të marrëdhënieve të pronësisë së truallit, dhe llogaritjen e qirasë.

Brenda muajit Dhjetor 2017 dhe në vijimësi

Gjetje 6: Në 1 rast që i përket ZK 3675, sipas referencës 522, regjistruar me leje ndërtimi pasuria nr.1/89-Nd, Dyqan-Garazh me sipërfaqe 200 m², në mungesë të dokumentacionit të marrëdhënieve të pronësisë si dhe në mungesë të dokumentacionit tjetër, në kundërshtim me ligjin e Planifikimit dhe zhvillimit të Territorit nr. 10119, datë 23.04.2009, të ndryshuar, ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Rregulloren e Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, Kreu IV, pika 12, për lejet në vitet 1998 e në vazhdim.

Nga llogaritja e vlerës së truallit për sipërfaqen prej 200 m², për të cilat mungojnë marrëdhëniet e pronësisë, bazuar në VKM nr. 514, datë 30.07.2014, **rezulton një vlerë prej 82,600 lekë e papaguar, dhe nga llogaritja e qirasë për 3 vjet llogaritet një detyrim i papaguar në vlerën 300,000 lekë që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**.

Rekomandimi 6.1: Regjistruesi i ZVRPP Mat të marrë masa që në bazë të pikës 1, neni 5; pikës 1 neni 49 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr.1 /89- Nd, në ZK 3675, me referencës nr. 0522, deri arkëtimin e detyrimit të përcaktuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi në vlerën prej 300,000 lekë dhe plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor (*Lidhjen e kontratës për marrëdhëniet me truallin me qira apo shitje*).

Sqarim:

Rekomandimet e dërguara nga KLSH për pagesën e diferencës së llogaritur për detyrime nga përfituesit e pronave si nga privatizimet dhe nga transaksione të tjera, të gjetura dhe rekomanduara në ZVRPP Mat, nuk ligjërojnë statuset juridike të pasurive, nëse kanë mangësi të tjera ligjore në përfitim të padrejtë të këtyre pasurive.

Regjistruesi të vlerësojë masat e kufizimit konform detyrimit ligjor, duke kufizuar veprimet në këto pasuri deri në plotësimin e mangësisë apo paligjshmërisë me diferenca në vlerë ose me mungesa dokumentacioni dhe parandaluar kryerjen e transaksioneve të pronës me të tretët, si dhe të kërkojnë plotësimin e mangësive që statusi juridik i pronës të konsolidohet.

C. MASA DISIPLINORE

C/1. Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, dhe në ligjin nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e

Pasurive të Paluajtshme”, si dhe në kontratën individuale të punës, **t’i kërkojmë Kryeregjistruesit ZQRPP Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë dhe marrjen e masave disiplinore, për punonjësit si më poshtë:

I. “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”

1. Për z. M.S, me detyrë Hartograf, për 18 raste:

*Në 17 raste që i përkasin ZK 2161 Klos, dhe 1326 Burrel janë regjistruar objekte me leje legalizimi sipas referencave nr. 1166, 1225, 1070, 1076, 0329, 1170, 1184, 1095, 1081, 1099, 0896, 0994, 0119, 1077, në pasuri shtetërore evidentuar në KPP me një sipërfaqe ndërtimore **1169 m2, duke shkaktuar një dëm ekonomik** në vlerën prej **46,837,154 duke vepruar në kundërshtim me procedurat e përcaktuara me Udhëzimin e Përbashkët të ZRQPP dhe ALUIZNI-t nr. 4695 dhe 4688, datë 31.05.2016 pika 6, 8, 9, 10, dhe VKM nr. 756, datë 26.10.2016 pika 9, në kundërshtim me pikën 8, Seksioni II, të Udhëzimit Metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelave të pasurive të paluajtshme” dhe Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, Kreu II, pika 10.6, me nenin 42, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 dhe me pikën 2 e 3, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” .***

*Në 1 rast që i përkasin ZK 2161 Klos, sipas referencës nr. 1124, regjistruar truell 200 m2 dhe ndërtesë. 97 m2 në kundërshtim me procedurat e përcaktuara nga VKM 608, datë 05.09.2012, pikat, 5, 6, 8, 9, dhe në papajtueshmëri me pikën “iii” shkronjës “b” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me **mungesa të dokumentacionit zyrtar nga Pushteti Vendor që provojnë se ndërtimet janë bërë para vitit 1991.***

II- Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna për:

1. Për z. R.N, jurist, 2 raste:

*Në 2 raste që i përkasin ZK 2161 Klos, sipas referencave nr. 1152, 1153 regjistruar truell 450 m2 dhe ndërtesë. 257 m2. në kundërshtim me procedurat e përcaktuara nga VKM 608, datë 05.09.2012, pikat, 5, 6, 8, 9, dhe në papajtueshmëri me pikën “iii” shkronjës “b” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me **mungesa të dokumentacionit zyrtar nga Pushteti Vendor që provojnë se ndërtimet janë bërë para vitit 1991. Meqenëse subjekti S T ka përfutuar padrejtësisht truallin në bazë të VKM nr. 812, datë 16.11.2016 duhet të shlyejë detyrimin për blerjen e truallit në vlerën 600,000 lekë.***

C/2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL

I. Për ish drejtuesit dhe ish punonjësit që janë në marrëdhënie pune dhe nuk kanë adresim institucional, nuk rekomandojmë masa disiplinore. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara për këta persona masa disiplinore do të ishte nga **“Vërejtje”** deri në **“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”**, përkatësisht për:

- | | |
|--------------------|-----------------------------------|
| 1. Z.A.F | me detyrë ish Regjistrues, |
| 2. Znj.D.S, | me detyrë ish-Juriste |
| 3. Znj.Th.B | me detyrë specialiste |
| 4. Z.E.GJ | me detyrë ish-regjistrues |
| 5. Z.E.D | me detyrë ish-regjistrues. |

-Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar me ligjin nr. 33/2012 datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 1, të UKM nr. 1, datë 31.07.2007 “Për proceduarat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe kërkesave të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” dhe të Rregullores për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999 të ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore.

Bazuar në nenin 281, të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bazuar në ligjin nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, per veprime në papajtueshmëri me pikën a, neni 25, 29 dhe neni 39 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” me kreun III, pika 1, kreun IV, pika 21, 22/3, kreun VI, pikat 3 dhe 3.1 të Rregullores për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nga punonjësit e ZVRPP Mat, bazuar në nivelin e shkeljeve të evidentuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit marrja e masave të lihet në vlerësim të ZQRPP Tiranë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Administrimit të Aseteve dhe Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R